



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 150, datë 15.06.2022

PËR

**“MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT  
PËR PROKUROREN DOLOREZA MUSABELLIU”**

Bazuar në nenin 149/ç, të Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, në nenin 9 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në germën “a”, të pikës 1, të nenit 189, të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 8 të Rregullores së Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, pasi u njoh me kërkesën me Nr.1032 prot., datë 14.06.2022, dhe relacionin e përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit, konkretisht qenien ekspert për zonjën Doloreza Musabelliu, pranë UNDOC në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës dhe Akademinë e Sigurisë, në kuadër të një projekti me fokus hetimin dhe gjykimin e veprave penale për trafikimin e qenieve njerëzore.
2. Veprimtaria jashtë funksionit do të ushtrohet për periudhën kohore 15-17 qershor 2022, me një total prej 3 ditësh pune.
3. Të njoftohet për këtë vendim zonja Doloreza Musabelliu dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
5. U shpall në Tiranë, sot më 15.06.2022.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj



ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ANËTAR  
Nurihan Seiti

ANËTAR  
Elaida Goxhi

ANËTAR  
Esmeralda Keshi

ANËTAR  
Ludovik Dodaj

ANËTAR  
Zeqir Hoda

ANËTAR  
Mirela Bogdani